VENDIM
Nr.120, datë 28.3.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE "ABC NEWS"
SUBJEKTIT: SHOQËRIA "ABC NEWS" SHA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit "ABC News" sh.a. për t'u licencuar si operator radiofonik privat vendor;

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit, shoqërisë "ABC News" sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë - Durrës, qytetin e Fierit dhe qarkun e Vlorës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati